01-1391

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22, 44 dhe 45 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Admnistrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe duke vendosur sipas kërkesës **05 Nr.350/02-148963/22 dt. 28.06.2022,** të pronarëve: *Ylber Krasniqi, Hamdi Kryeziu, Betim Mulaku, Elfete Osmani Maloku, Vahide, Ramiz, Namon, Zymer, Jakup, Imer, Ismet, Skender, Sadri, Fazli, Selatin. Lumnije, Alberina, Diamant, Gazmend, Perparim, Arbrora, Besnik, Burim dhe Valon Gashi, Vjollca Gashi Hoxha dhe Ardona Hysenaj,* ***me Investitor "R & Rukolli" sh.p.k. nga Skenderaj me certifikatë të biznesit ARBK 810618366 dhe me pronar Rrustem Rukolli nga Skenderaj,*** për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit të ndërtesave shumëbanesore afariste, në kuadër të bllokut urban "A-13", të tërësisë hapësinore "A" të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër" në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 20.06.2023, merr këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore pronarëve: *Ylber Krasniqi, Hamdi Kryeziu, Betim Mulaku, Elfete Osmani Maloku, Vahide, Ramiz, Namon, Zymer, Jakup, Imer, Ismet, Skender, Sadri, Fazli, Selatin. Lumnije, Alberina, Diamant, Gazmend, Perparim, Arbrora, Besnik, Burim dhe Valon Gashi, Vjollca Gashi Hoxha dhe Ardona Hysenaj,* ***me Investitor "R & Rukolli" sh.p.k. nga Skenderaj me certifikatë të biznesit ARBK 810618366 dhe me pronar Rrustem Rukolli nga Skenderaj,*** sipas kërkesës **05 Nr.350/02-148963/22 dt. 28.06.2022**, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit të ndërtesave shumëbanesore afariste, në kuadër të bllokut urban "A-13", të tërësisë hapësinore "A", Tipologjia e ndërtimit "D", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale **nr.912-7, 912-8, 912-9, 912-10, 912-11 ZK.Matiçan, nr.1672-2, 1672-3, 1672-6, 1672-11 dhe 1672-12,** ZK Prishtinë dhe parcelës kadastrale nr.919-0, ZK.Matiçan

II. Lokacioni i kompleksit të parcelave për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të bllokut urban "A-13", të tërësisë hapësinore "A", Tipologjia e ndërtimit "D", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër" në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Komunës së Prishtinës, 01 nr. 035-186861 dt. 02.10.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është e destitnuar me funksion të përzier BP, banim afarizëm joshqetësuese në përdhesë me tipologjinë e ndërtimit "D", me koeficinet ndërtimi 3, ISHP 40%, ISGJ 40%, ISN 60% dhe etazhitet maksimal të lejuar IV-VIII.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit/parcelës së lartcekur sipas gjendjes, kadastrale, pronësore, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:
  - nr.912-7, ZK.Matiçan, sipërfaqja S=903 m², pronare: Ylber Krasniqi, kualiteti i tokës "Kullosë klasës 4";
  - nr.912-8, ZK. Matiçan,, sipërfaqja S=457 m², pronare: Ylber Krasniqi, kualiteti i tokës "Kullosë klasës "Arë e klasës 4";
  - nr.912-9, ZK. Matiçan,, sipërfaqja S=396 m², pronare: Hamdi Kryeziu, kualiteti i tokës "Kullosë klasës 4";

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- nr.912-10, ZK. Matiçan, sipërfaqja S=382 m², pronar: Betim Mulaku , kualiteti i tokës "Kullosë klasës 4";
- nr.912-11, ZK. Matiçan,, sipërfaqja S=751 m², pronare: Elfete Osmani Mulaku, kualiteti i tokës "Kullosë klasës 4";
- nr.1672-2, ZK.Prishtinë, sipërfaqja S=2,989m², pronarë: *Vahide, Ramiz, Namon, Zymer, Jakup, Imer, Ismet, Skender, Sadri, Fazli, Selatin. Lumnije, Alberina, Diamant, Gazmend, Perparim, Arbrora, Besnik, Burim dhe Valon Gashi, Vjollca Gashi Hoxha dhe Ardona Hysenaj*, kualiteti i tokës "Arë e klasës 4";
- nr.1672-3, ZK.Prishtinë, sipërfaqja S=2,989 m², pronare: *Vahide, Ramiz, Namon, Zymer, Jakup, Imer, Ismet, Skender, Sadri, Fazli, Selatin. Lumnije, Alberina, Diamant, Gazmend, Perparim, Arbrora, Besnik, Burim dhe Valon Gashi, Vjollca Gashi Hoxha dhe Ardona Hysenaj*, kualiteti i tokës "Arë e klasës 4";
- nr.1672-6, ZK.Prishtinë, sipërfaqja S=2,989 m², pronar:*Vahide, Ramiz, Namon, Zymer, Jakup, Imer, Ismet, Skender, Sadri, Fazli, Selatin. Lumnije, Alberina, Diamant, Gazmend, Perparim, Arbrora, Besnik, Burim dhe Valon Gashi, Vjollca Gashi Hoxha dhe Ardona Hysenaj*, kualiteti i tokës "Arë e klasës 4";
- nr.1672-11, ZK.Prishtinë, sipërfaqja S=690 m², pronar:*Vahide, Ramiz, Namon, Zymer, Jakup, Imer, Ismet, Skender, Sadri, Fazli, Selatin. Lumnije, Alberina, Diamant, Gazmend, Perparim, Arbrora, Besnik, Burim dhe Valon Gashi, Vjollca Gashi Hoxha dhe Ardona Hysenaj*, kualiteti i tokës "Arë e klasës 4";
- nr.1672-12, ZK.Prishtinë, sipërfaqja S=1,189 m², pronar: *Vahide, Ramiz, Namon, Zymer, Jakup, Imer, Ismet, Skender, Sadri, Fazli, Selatin. Lumnije, Alberina, Diamant, Gazmend, Perparim, Arbrora, Besnik, Burim dhe Valon Gashi, Vjollca Gashi Hoxha dhe Ardona Hysenaj*, kualiteti i tokës "Arë e klasës 4";

Sipërfaqja e tërësishme e parcelave kadastrale..... S=13,735m².

Në kuadër të bllokut urban "A-13", shtrihet edhe parcela kadastrale me nr..919-0, ZK.Matiçan, me S=389m², me pronwsi komunale e planifikuar tw kwmbehet ;

Sipërfaqja e tërësishme e parcelave kadastrale dhe me kwtw parcelë është ..... S=14,124m².

- E drejta pronësore-juridike e parcelës së lartcekur, është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelave kadastrale të lartcekura nuk ka ndërtesa ekzistuese;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka pjerrtësi në drejtimin veri-jug, me disnivel ~13m';
- Qasja në parcelat kadastrale është planifikuar përmes rrugës së planifikuar brenda bllokut urban "A13", e planifikuar ti shërbej si rrugë e brëndshme bllokut në tërësi. Kjo rrugë ka qasje nga rruga e planifikuar me Planin Rregullues "Prishtina e re-Zona Qendër";
- Parcelat kadastrale për të cilën kërkohet caktimi i kushteve ndërtimore, shtrihen në kuadër të bllokut urban "A-13" të tërësisë "A", të Planit Rregullues "Prishtina e re-Zona Qendër", dhe pjesërisht shtrihen në rrugën e planifikuar të Planit Rregullues të lartcekur;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m' të parcelës kadastrale, ka ndërtesa të larta banesore, administrative si dhe shtëpi individuale banimore;

IV. Projekti konceptual – "zgjidhja urbane" e ndërtesave banesore dhe afariste, e analizuar/trajtuar me këto kushte ndërtimore, është konceptuar më gjithsejt me shtaë(7) ndërtesa afariste banesore, e planifikuar në dy faza zhvillimore "F-1" dhe "F-2". Ku Faza I e zhvillimit përfshinë ndërtesat 1,2,3 dhe 4 me etazhitet 2B+S+P+8 deri nw 2B+S+P+11 ndërsa Faza e dytë "F-2" përfshinë ndërtesat 5,6 dhe 7, me etazhitet nga 2B+S+P+9 dhe 2B+S+P+10, më këndët ë lojërave për fëmijë, hapësirën e lirë gjëlbëruese, parkingjët nën dhe mbi tokësore, parkingjet për biciklistë, parkingjet me mbushës elektrik, sistemin në kuadër të ndërtesës për largimin e mbeturnave si dhe shtigjet për këmbësor dhe kalimin e veturave. 2, të shtrira në drejtimin veri lindje dhe jug lindje dhe jugperëndim.Me anë të kësaj zgjidhje urbane poashtu miratohet vazhdimi i rrugës së planifikuar me zgjidhjet paraprake paralel me vijën e tramvajit urban sipas planit rregullues, dhe e nëjta do ju shërbej edhe blloqeve të tjera në varësi të planifikimit të zonës në vijim dhe sipas vlerësimit të kësaj drejtorie.

V. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar në kuadër të parcelës ndërtimore, në kuadër të pjesës së bllokut

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

urban "A-13", të tërësisë hapësinore "A", Tipologjia e ndërtimit "D" të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër" në Prishtinë, përcaktohen bazuar në parametrat, kriteret urbane, kushtet për ndërtim për realizimin-ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste, dhe hapësira përcjellëse, janë:

- Organizimi dhe qasja në kompleks, pozicionimi, gabaritet, etazhiteti i ndërtesave, raporti i ndërtesave me vijën rregulluese dhe ndërtimore, si dhe me distanca nga kufiri i parcelës, rrugët dhe vend parkimet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit-"zgjidhja urbane", bashkëngjitur këtij vendimi për caktim të kushteve ndërtimore;
- Parcelat kadastrale të trajtuara në kuadër të pjesës së bllokut urban "A-13", Tipologjia e ndërtimit "D" dhe "D", për realizimin e kompleksit të ndërtesave shumëbanesore afariste, konkretisht parcelave kadastrale e trajtuar brenda vijës rregulluese, janë:
  - nr.912-7, ZK. Matiçan, sipërfaqja S=903 m²;
  - nr.912-8, ZK. Matiçan, sipërfaqja S=457 m²;
  - nr.912-9, ZK. Matiçan, sipërfaqja S=396 m²;
  - nr.912-10, ZK. Matiçan, sipërfaqja S=382 m²;
  - nr.912-11, ZK. Matiçan sipërfaqja S=751 m²;
  - nr.1672-2, ZK.Prishtinë, sipërfaqja S=2,989 m²;
  - nr.1672-3, ZK.Prishtinë, sipërfaqja S=2,989 m²;
  - nr.1672-6, ZK.Prishtinë, sipërfaqja S=2,600 m²;
  - nr.1672-11, ZK.Prishtinë, sipërfaqja S=690 m²;
  - nr.1672-12, ZK.Prishtinë, sipërfaqja S=1,189 m²;

Sipërfaqja e tërësishme e parcelave kadastrale..... S=13,346m²;

Brenda vijës së rregullimit wshtw planifikuar edhe pjesa e parcelës kadastrale nr.919-0, ZK.Matiçan pronë Komunale me S=389m², të cilat do të përfshihen në ndërtim në fazën e dytë të ndërtimit pas realizimit të procedurës së këmbimit;

Pas zhvillimit të këtyre procedurave sipërfaqja e tërësishme e parcelave brenda vijës së rregullimit arrin sipërfaqen **S=13,735m²;**

- Parcelat kadastrale me sipërfaqen e trajtuar, në pjesën e bllokut urban "A-13", për realizimin e kompleksit të ndërtesave dhe afariste, që përfshihen në ndërtim-parcelë ndërtimore, konkretisht pjesa e parcelave kadastrale, e trajtuar jashtë vijës rregulluese, është:
  - nr.1672-6, ZK.Prishtinë, sipërfaqja S=389 m²;

    Sipërfaqja e parcelës kadasrale nr.1672-6, ZK.Prishtinë, jashtë vijës rregulluese me sipërfaqe prej S=389m², me anë të këtyre Kushteve Ndërtimore është planifikuar të Këmbehet me pjesën e parcelës kadastrale nr.919-0, ZK.Matiçan, me S=389m², e cila gjendet në kuadër të bllokut urban "A13" të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër".
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës ndërtimore, në kuadër të pjesës së bllokut urban "A-13", të tërësisë hapësinore "A" të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër", planifikohet të ndërtohen ndërtesat shumë banesore dhe afariste, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

- **Ndërtesa "Objekti 1" - S=8,806.70m² / 7,312.05m²**, mbi tokë + **1,494.65m²**, nën tokë/,
  Etazhitet: **2B+S+P+11;**
- **Ndërtesa "Objekti 2" - S=8,210.00m² / 6,715.35m²**, mbi tokë + **1,494.65m²**, nën tokë/,
  Etazhitet: **2B+S+P+10;**
- **Ndërtesa "Objekti 3" - S=6,449.42m² / 4,994.65m²**, mbi tokë + **1,454.78m²**, nën tokë/,
  Etazhitet: **2B+S+P+9;**
- **Ndërtesa "Objekti 4 dhe Afarizmi 2" - S=5,135.70m² / 3,846.64m²**, mbi tokë + **1289.06m²**, nën tokë/,
  Etazhitet: **2B+P+8;**
- **Ndërtesa "Objekti 5 dhe Afarizmi 3" - S=7,245.71m² / 5,604.82m²**, mbi tokë + **1,640.90m²**,nën tokë /,
  Etazhitet: **2B+S+P+9;**
- **Ndërtesa "Objekti 6" – S=7,676.45m² / 6,182.08m²**, mbi tokë + **1,495.38m²**, nën tokë /,
  Etazhitet: **2B+S+P+9;**

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- **Ndërtesa "Objekti 7"** - **S=8,399.53m² / 6,549.38m²**, mbi tokë + **1,850.16m²**, nën tokë /, Etazhitet: **2B+S+P+10;**

Totali : S=51,924.51m² / 41,204.95m²,mbi tokë + **10,719.56m²**, nën tokë /.

- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës kadastrale-parcelës ndërtimore (ISHP), konkretisht shfrytëzimi i parcelës brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesës në bazën-gabaritin e përdheses ose suterenit, është max. 40%, dhe kjo sipërfaqe është:
  S=13,346m² x 0.4=5, 338.40 m² / lejuar sipas planit rregullues/,
  S=389m² x 0.4=155.60 m² / lejuar sipas planit rregullues pwr parcelwn 919-0, ZK.Matiqan, KK.Prishtinw /,
  ISHP totale e lejuar S=5,494.00 e lejuar sipas planit rregullues
  S=4,166.41m² / sipas projekt propozimit /.
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të nëntokës (ISHPN), konkretisht shfrytëzimi i nëntokës së parcelës brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesës në bazën-gabaritin e bodrumit, është max.60%, bazuar në planin rregullues dhe në paragrafin II, pika 1. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe sipas grupeve-fazave të realizimit, kjo sipërfaqe është:
  S=13,346m² x 0.6=8007.60 m²/ e lejuar /,
  S=389m² x 0.6=233.40 m² / lejuar sipas planit rregullues pwr parcelwn 919-0, ZK.Matiqan, KK.Prishtinw /,
  ISHPN totale e lejuar S=8,241.00 e lejuar sipas planit rregullues
  S=4,316.82 m² / sipas projekt propozimit.
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (ISGJ), bazuar në planin rregullues dhe në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është 0.4 (40%), dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, 0.3 (30 %), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe kjo sipërfaqe është:
  S=13,346m² x 0.4=5, 338.40 m²/ e lejuar /,
  S=389m² x 0.4=155.60 m² / lejuar sipas planit rregullues pwr parcelwn 919-0, ZK.Matiqan, KK.Prishtinw /,
  ISGJ totale e lejuar S=5,494.00 e lejuar sipas planit rregullues
  S=4,225.00 m² (31.42%) dhe 1,344.60 m² (10%) / sipas projekt propozimit /.
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër" për zonën "D" të ndërtimit është max.3.0, dhe trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: ***100%*** për etazhet mbi kuotën ±0.00 dhe për etazhet me vëllim mbi ***51%*** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - ***suteren***, dhe ***0%*** për etazhet e nëntokës – ***bodrum***, dhe kjo sipërfaqe është:

Për zonën "D" te ndërtimit, S=13,346.00 m²x 3.0=40,038.00m²

- Me përfundimin e procedurës së këmbimit të pjesës së parcelës kadastrale nr.1672-6, ZK.Prishtinë me parcelën kadastrale Nr.919-0, ZK.Matiçan, bllokut i shtohet sipërfaqja ndërtimore si në vijim:

S=389x3=1,167.00m²

Dhe sipërfaqja e përgjithshme, e lejuar për ndërtim, do të jetë:

S=40,038.00m²+1,167.00m²=41,205.00m²,

Total sipërfaqja ndërtimore mbitokësore për ndërtesat e planifikuara është 41,151.65 m² ;

- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe efiçiencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë dhe tarifë për leje ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, të jetë ndërtim shumë banesor dhe afarizëm, si dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhesh etj. (sipas projekt propozimit);
- Etazhiteti maksimal për bllokun urban "A-13", të tërësisë hapësinore "A" të Planit Rregullues "Prishtina e Re–Zona Qendër", për tipologjinë e ndërtimit "D" është IV÷VIII etazhe mbi tokë, sipas projektpropozimit etazhiteti mbitokësor i propozuar është maks.deri ne S+P+11 dhe kjo si rezultat i këmbimit të pjesës ssë parcelës kadastrale të planifikuar në Infrastrukturë publike;

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- Bazuar në kriteret e planit rregullues, distanca minimale ballore në mes të ndërtesave të jetë 1.0xH (ku H, është lartësia mbi tokë e ndërtesës), kurse e ndërtesës me kufirin e parcelës fqinje 0.5xH ose min. 7 m, ku distanca prej 7.0 m vlen edhe në rastet kur në atë fasadë nuk ka hapje – ndriçim primar për hapësirat e banimit (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, korridore të banesave, etj).
- Distanca në mes të ndërtesave (shumë banesore apo afariste) te fasadat e kombinuara (njëra ndërtesë fasadë ballore, kurse tjetra ndërtesë fasadë anësore) është 0.6xH;
- Ngritja e nivelit të përdhesës nga niveli i terrenit- trotuarit të ndërtesës, lejohet max.1.20 m për banim dhe 0.45 për afarizëm;
- Bazuar në kriteret e Planit Rregullues për bllokun urban "A-13" për tipologjinë "D", afarizmi joshqetësues lejohet në përdhesë;
- Çdo ndërtesë duhet planifikuar të vendoset me fasadën e përparme në vijën ndërtimore, respektivisht përbrenda hapësirës së kufizuar me vijën ndërtimore, si me pjesën e ndërtesës mbi tokë ashtu edhe nëntokë, nuk lejohet tejkalimi i vijës ndërtimore.
- Në rrugët aktive me përmbajtje të ndryshme afariste, përdhesa preferohet të hyjë brenda vijës ndërtimore për maksimum 3 m, duke krijuar kështu strehë për hapësirën afariste dhe shteg më të gjerë të këmbësorëve;
- Çdo objekt ndërtimor i planifikuar duhet të jetë i vendosur, me fasadën e përparme në vijën ndërtimore, respektivisht përbrenda hapësirës së kufizuar me vijën ndërtimore;
- Qasjet në kompleks të jenë nga rrugët e planifikuara të planit rregullues urban, sipas planit të situacionit/zgjidhjes urbane;
- Për qarkullim më të lehtë të zjarrfikësve duhet të parashihet qasje e brendshme çdo 50 m`, përkatësisht në çdo 50 m duhet të ekzistojë pasazh apo rrugë, me gjerësi min. 4.0 m;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vend-parkimet e jashtme, shtigjet, trotuaret kënde të lojërave për fëmijë, terrene sportive, mobiliar urban, etj.;
- Për çdo njësi banesore-rezidenciale të planifikohet 1.0 (një) vend-parkim, ndërsa për pjesët afariste të ndërtesës, varësisht prej destinimit, të parashihen 1 VP / 30 m² të sipërfaqes së vlefshme të shitjes;
- Parcelat ndërtimore të ndërtesave shumëbanesore nuk duhet të rrethohen;
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efiçiencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;
- Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuar në kriteret dhe parametrat urban të Plani Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër".

VI. Këmbimi i pjesës së parcelës kadastrale me Nr.919-0, ZK.Matiçan me S=389m², në pronësi të KKPrishtina, do të realizohet me pjesën e parcës kadastrale me nr.1672-6, ZK.Prishtinës, me sipërfaqe S=389m², e të përfshirë në rrugë të planifikuar sipas Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër" në Prishtinë, bazuar në vlerësimin e organit kompetent.

Andaj, drejtoria jep PËLQIM për këmbimin e parcelave të lartë cekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane","Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe Manuali i këmbimit punuar nga gjeometri i licencuar dhe i bashkangjitur kësaj kërkese. Procedura e këmbimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, dhe bazuar në vlerësimin e organit kompetent, dhe e cila do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e këmbimit të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore, për fazën e dytë të ndërtimit "F-2", gjegjësisht para aplikimit për leje ndërtimore për ndërtesat 5, 6 dhe 7, në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-144 dt. 22.11.2012, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

VII. Ndarja/parcelimi i parcelave kadastrale, nr.919-0, ZK.Matiçan dhe nr.1672-6, ZK.Prishtinës, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore, e përcaktuar me vijën rregulluese të bllokut urban "A-13", si dhe bazuar në Plani i situacionit-"zgjidhja urbane", dispozitën urbanistike, punuar nga kjo drejtori, dhe manualin e ndarjes të punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manuali i ndarjes dhe bashkimit, punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes duhe të të bëhet para aplikimit për leje të ndërtimit dhe kjo rocedurë do të zhvillohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas vendimit të kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - "zgjidhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VIII. Bashkimi i pjesëve & parcelave kadastrale nr. **nr.912-7, 912-8, 912-9, 912-10, 912-11 ZK.Matiçan, nr.1672-2, 1672-3, 1672-6, 1672-11 dhe 1672-12,** ZK Prishtinë dhe parcelës kadastrale nr.919-0, ZK.Matiçan, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore "A-13", të përcaktuar me vijën rregulluese me rrugët e planifikuara të planit rregullues urban , bazuar në Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", si dhe Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga PRR "Prishtina e re-Zona Qendër" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manuali i bashkimit punuar nga gjeometri i licencuar.

Andaj, drejtoria jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" & Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkim të punuar nga gjeometri i liçencuar.

Procedura e bashkimit do të realizohet në dy faza. Faza e parë do të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore për fazën e parë të zhvillimit "F-1", e cila përfshinë ndërtesat 1,2,3 dhe 4 , dhe do të përfshij parcelat kadastrale **nr.1672-2, 1672-3, 1672-6, 1672-11 dhe 1672-12,** ZK Prishtinë, ndërsa faza e dytë e bashkimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore për fazën e dytë të zhvillimit "F-2", e cila përfshinë ndërtesat 5,6 dhe 7 , dhe do të përfshij parcelat kadastrale **nr.912-7, 912-8, 912-9, 912-10, 912-11 ZK.Matiçan** dhe pjesën e parcelës kadastrale nr. 919-0, ZK.Matiçan, pas realizimit të procedurës së këmbimit të paragrafit VI, bazuar në Vendimin e kushteve ndërtimore dhe bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e cila do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operatin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Bashkimi të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, me kërkesë të pronarëve & investitorit, si dhe bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga P.RR "Prishtina e Re-Zona Qendër" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkimit punuar nga gjeodeti i licencuar .

IX. Kyçja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit, numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos" - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

X. Dokumentacioni ndërtimor/projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinore, "Rregullore MMPH Nr. 03/2016 për normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", bazuar në "Udhëzim Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara", normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;

Komuna e Prishtinës-Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net

- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50 m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit , me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro-energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vendndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

XI. Dokumentacioni ndërtimor - Elaborati për **Masat e mbrojtëse nga zjarri**, hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

XII. Leja Mjedisore Komunale – bazuar në nenin 9, pika 1 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale, përkatësisht shtojcës së këtij udhëzimi, aktiviteti i propozuar sipas projektit konceptual-kompleks me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, i nënshtrohet procedurës për pajisje me Leje Mjedisore Komunale. Dokumentacioni ndërtimor-Elaborati për Leje Mjedisore Komunale, i hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

